



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 255/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: NTP "Lulishtja Buçaj" – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Nt Biti Com", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës", me nr.prok. 616/18/007/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datë: 06.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "NTP Lulishtja Buçaj" – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës", me nr.prok. 616/18/007/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës", me nr.prok. 616/18/007/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “NTP Lulishtja Buçaj” – Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 30.01.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 07.03.2018, ku kanë marrë pjesë gjashtë (6) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: NTP “Lulishtja Buçaj” – Prishtinë, tenderues i pasuksesshëm nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 28.05.2018.

Njoftimi për dhënien e kontratës nga Autoriteti Kontraktues është bërë me dt: 31.05.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: NTP “Lulishtja Buçaj” – Prishtinë, me dt: 06.06.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 07.06.2018, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: NTP “Lulishtja Buçaj” – Prishtinë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: NTP “Lulishtja Buçaj” – Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 12 qershor 2018, me nr. 255/18, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës”, me nr.prok. 616/18/007/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 6, 7, 59, 60, 69, 70, 111, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.06.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-profesional, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 25.07.2018, sqaron se me datë 19.06.2018 kam pranuar autorizimin për shqyrtimin e ankesës nr.prot.255/18 e datës 12.06.2018, e parashtruar nga OE ankues NTP “Lulishtja Buçaj”, me seli në Graçanice, kundër Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e

Prokurimit: Furnizim me druje dekorativ ne Hapësirat dhe parqet e qytetit te Prishtinës, me nr.prok.616-18-007-111, duke u bazuar në shkresat e lendes si dhe informacionin e marruar nga zyra për pranimin e ankesës, ju njoftoj se ankesa në fjalë është e pa - afatshme për faktin se e njëjta ankesë është parashtruar me vonesë jashtë afatit ligjor siç parashihet me nenin 108/A, paragrafi 3 i LPP-së, në këtë rast OE ankues ka humbur afatin ligjor për parashtrim të ankesës siç parashihet në nenin 108/A, paragrafi 3 i LPP-së, duke parashtruar ankesë në Autoriteti kontraktues jashtë afatit ligjor. Eksperti profesional në bazë të Rregullores së brendshme të OSHP nr.01/2017, neni 17, paragrafi 3, REKOMANDON, kryetarin e OSHP, që ankesa në fjalë të refuzohet apo hedhet poshtë si e pa afatshme siç parashihet me këtë nen (neni 17, parag.3) citojmë: (shqyrtimi paraprak i ankesës): “Nëse ankesa është e jashtë afatshme sipas ligjit, atëherë do të njoftohet kryetari i OSHP-së që të refuzoj apo të hedhë poshtë ankesën si të jashtë afatshme”.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues profesionali propozon panelit shqyrtues që ankesë e OE ankues të aprovohet si e pa bazuar - jashtë afatit ligjor (për arsyen që u cek me larte), dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK Komuna e Prishtinës.

Autoriteti Kontraktues – Komuna Prishtinë, me datë: 27.07.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: NTP ”Lulishtja Buçaj” – Prishtinë, me datë: 26.07.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 06.08.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues- profesional OSHP-së,u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Buçaj deklaroj: Me 28.05.2018 AK ka marr vendim lidhur me këtë aktivitet, ndërsa ne si OE me 31.05.2018 njoftimin. Emilin nga Flamur Sallahu shkruan se afati për ankesë është 5 ditë kalendarike. Ne kemi kërkuar qasje në dokumente me 31.05.2018 menjëherë pas pranimin të njoftimit për dhënie të kontratës, përgjigjen nga zyrtari i prokurimit kemi pranuar se mund të kemi qasje me 04.06.2018. Pra ne jemi brenda afatit ligjorë sepse pa pasur qasje në dokumente zyrtare nuk

kemi mund të parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim. Kur na ka arritur letra standarde për tenderues të pasuksesshëm ka ardhur me datë 28.05.2018 që edhe këtu e kanë gabuar datën. Ne kemi qenë në AK për qasje në dokumente me 04.06.2018 dhe me 05.06.2018 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Po ashtu me 05.06.2018 AK na kanë dërgua kërkesë për sqarim të ankesës. Sipas neni 108A pika 5 definon se kurë kërkohet sqarim ka afat për dy ditë për të kthyer përgjigje. Ne me 06.06.2018 i kemi kthyer përgjigje AK-së. Po ashtu kemi edhe argumente tjera se certifikata fitosanitare nuk ka qenë e ligjshme e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, dhe kjo certifikatë është e falsifikuar. Si krahasim i ofroj panelit një certifikatë fitosanitare se si duket në realistet, ndërsa certifikata OE nuk përmban të dhënat kryesore, nuk përmban datë, nuk përmban numër serik, nuk përmban peshë dhe po ashtu është në gjuhë italiane e cila nuk njihet nga LPP. Po ashtu tenderi në lagjen Arbria me vlerë 10.000€ AK-KK Prishtinë kanë kërkuar Inxhinier të diplomuar, certifikata fitosanitare etj, ndërsa në këtë aktivitet që është me vlerë 115.000€ nuk kanë kërkuar as agronom, as referenca etj.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK z.Sallahu deklaroi: Ne si AK gjatë vlerësimit të këtij tenderi për OE ankues ka parashtruar ankesë jashtë afatit, duke marr për bazë dy elementet kryesore të afatit ligjorë, ne kemi konstatua se pala së pari nuk bërë precizimin e ankesës, ku lart në titull nuk ka adresuar ankesën për KK Prishtinë dhe ka adresuar direkt OSHP-në, do thotë ka kaluar në shkallën e dytë duke mos respektuar parimin e shkallës së parë. Po ashtu me datë 28.05.2018 kemi ngarkuar letër standarde për OE-të, ku evidentimin mund ta gjeni në sistemin e Elektronik të KRPP-së. Neni 22 i UOPP-së përcakton afatet ligjore për parashtrim të ankesës, dhe sipas kësaj dispozite ligjore OE ankues e ka tejkaluar afatin ligjore për parashtrim të ankesës. Pretendimi ankimor ka qenë për afat ligjor dhe jo për certifikata. Lidhur me certifikatat ka pas vendim të mëhershëm të OSHP-së dhe me rastin e rivlerësimit kemi zbatuar vendimin e OSHP. Ne pajtohemi me raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z.Tafa deklaroi: Në këtë rast nuk kam dhënë mendim vetëm se kam njoftuar panelin shqyrtues se OE ankues ka bërë ankesë të jashtë afatshme sipas shkresave që kam pas në dispozicion lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është dërguar me 28.05.2018, kërkesa për rishqyrtim është bërë me 06.06.2018. me këtë kjo ankesë është e jashtë afatshme dhe si e tillë është e papranueshme.

Anëtar i panelit shqyrtues z.Paçarizi pyeti ekspertin se a keni shqyrtuar komunikimet mes OE ankues në këtë rast me AK-në, a keni marr parasysh këto komunikime.

Në përgjigje z.Tafa deklaroj: letra standarde dhe kërkesa për rishqyrtim janë dokumentet mbi të cilat kam bazuar konstatimin se ankesa është e jashtë afatshme.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Buçaj deklaroj: I propozojmë edhe njëherë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën e OE ankues të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK z.Sallahu deklaroj: Qëndrojmë pranë vendimit të OSHP-së dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar.

Në fund eksperti shqyrtues z.Tafa deklaroj: Qëndroj pranë raportit të ekspertizës.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues ka kërkuar qasje në dokumente me dt:31.05.2018 menjëher pas pranimi të njoftimit për dhënie të kontratës (edhe pse letra standarde i është dërguar me dt:28.05.2018), ndërsa përgjigjen nga zyrtari i prokurimit e kanë pranuar se mund të kenë qasje me dt:04.06.2018 (që i bie dita e fundit për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim).

Pra OE ankues ka pasur qasje në dokumente me dt:04.06.2018 dhe menjëherë e ka përgatitur kërkesën dhe me dt:06.06.2018 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka respektuar nenin 10 paragrafi 3 të LPP-së ku shkruan se autoriteti kontraktues i ofron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e aktivitetit. Me këtë veprim të autoritetit kontraktues i është mohuar e drejta e operatorit ekonomik që të përpilojë pretendime ankimore të sakta në mungesë të të dhënave, ndërsa me këtë veprim të autoritetit kontraktues mund të kuptohet edhe qëllimi i autoritetit kontraktues për favorizim të kompanisë së caktuar dhe diskriminim të kompanisë ankuese, e që ky veprim është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues përkitazi me certifikaten fitosanitare ka vendosur më vendimin Nr.137/18 të dt:15.05.2018 ku ka sqaruar se është kërkuar certifikata sanitare e prejardhjes së mallit nga BE, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatë fito sanitare e cila është për dhe (substrat), dhe nuk ka treguar prejardhjen se drunjtë janë me prejardhje nga BE, ndërsa ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me furnizim me drunj dekorativ e jo furnizim me dhe.

Duke pasur parasysh që autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik “Nt Biti Com” (sikurse herën e parë), edhe pse me vendimin e OSHP-së Nr.137/18 ishte konstatuar që është i papërgjegjshëm, si dhe duke pasur parasysh që autoriteti kontraktues në mënyrë diskriminuuese nuk i ka ofruar qasje të arsyeshme operatorit ekonomik ankues, paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues para së gjithash ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së pasi që veprimet e personave kompetent të AK-së janë shoqëruar me një shkallë të lartë të diskriminimit dhe me një shkallë të lartë jo transparencës gjatë udhëheqjes së kësaj procedure, ndërsa paragrafi 3 i nenit 1 të LPP-së parasheh qartë si në vijim *“Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji”*.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar vendimin e OSHP nr. 137/18 të dt:15.05.2018 dhe njëkohësisht nuk e ka informuar OSHP për veprimet e ndërmarra brenda 10 ditëve, ashtu siç ishte parashikuar në piken III të dispozitivit të vendimit të lartpërmendur.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Komuna Prishtinë

1x1 OE - NTP "Lulishnja Buçaj" – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA